



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E SIGURISË
USHQIMORE, VETERINARISË, MBROJTJES SË BIMËVE DHE PESHKIMIT

Nr 3708/1 prot.

Tiranë, më 14 05 2026

NJOFTIM PUBLIK

Lënda: Njoftimi i subjektit për shkresën me lëndë: “Njoftim paraprak para marrjes së vendimit përfundimtar mbi shfuqizimin e kontratës Nr. 2248 prot., datë 17.03.2017, lidhur me MBZHR për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit artizanal në objektin ujor “Laguna Orikum”.

Organi publik: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Drejtuar: Shoqërisë “FISH PLANET” sh.p.k.

Përfaqesuar nga administratori Z. Helidon Rruga

Baza ligjore:

- Neni 162 i Kodit të Procedurave Administrative;
- Nenet 698–703 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
- Dispozitat përkatëse të kontratës Nr. 2248 prot., datë 17.03.2017.

-Me ane të këtij njoftimi publik, shoqëria “FISH PLANET” sh.p.k. vihet në dijeni, nga MBZHR, për shkresën drejtuar këtij subjekti, me nr. Prot. 159/2, datë 07/01/2026.

-Subjekti ka të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e konsiderimit të këtij njoftimi si të kryer, të paraqesë shpjegime me shkrim dhe/ose të kërkojë zhvillimin e një seance dëgjimore pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

-Në mungesë të paraqitjes së shpjegimeve brenda këtij afati, apo në rast se ato nuk vlerësohen të bazuara, Ministria do të vijojë me procedurat për shfuqizimin/zgjidhjen e njëanshme të kontratës.

Ky njoftim publik konsiderohet i kryer pas 10 (dhjetë) ditësh nga data e shpalljes së tij, në përputhje me nenin 162, pika 3 dhe 4 të Kodit të Procedurave Administrative.

Të dhëna për njohjen me aktin e plotë:

Subjekti mund të njihet me përmbajtjen e plotë të shkresës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe

nëpërmjet kërkesës me shkrim drejtuar MBZHR-se.

Shpallur më datë: 15/05/2026

Hiqet më datë: 26/05/2026

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ismail Shehu

